

# Algoritmi i Konsultimit të Astmës në Distançë

## 1. Organizimi

- Përgatituni dhe përcaktoni se si do të lidheni - shiko kartelën mjekësore të pacientit
- Telefonatë
- Telefonatë me video (për gjendje të rëndë, për pacientët anksioz, për sëmundje bashkëshoqëruese, pacientët me vështirësi në dëgjim)

## 2. Lidhja

- Kontrolloni videon dhe audion
- Psh. Mund të më dëgjoni/shihni?
- Konfirmimi identitetin e pacientit
- Emri
- Data e lindjes
- Kontrolloni se ku ndodhet pacienti
- Ku ndodheni aktualisht?
- Shënimi numrin e telefonit të pacientit në rast se lidhja shpëputet
- Nëse është e mundur, sigurohuni që pacienti të ketë privatësi

## 3. Filloni

- Vlerësimin e shpejtë
- Nëse pacienti ka fishkëllimë ose duket shumë i sëmurë, si për shembull ka shumë vështirësi në frymëmarrje për të folur ose kalon direkt te pyetjet klinike kyçe
- Përcaktoni atë çka pacienti pret nga konsulta, si:
- Vlerësimi klinik, Referim, Certifikatë, Siguri

## 4. Historiku

- Vlerësoni simptomat akute, kontrollin, shkallën e rëndesës së astmës
- Pyesni rreth shkaktarëve të astmës
- Historiku i ri-akutizimeve

## 5. Ekzaminimi

Nëpërmjet telefonit:

- Kërkojini pacientit t'ju përshkruajë gjendjen e frymëmarrjes ose gjetje të tjera

Nëpërmjet videos:

- Kërkojini pacientit t'ju tregojë konstatimet
- Kërkojini pacientit t'ju tregojë teknikën e inhalimit

Pacienti mund të jetë në gjendje të kryejë vetë matjet nëse i ka instrumentet në shtëpi:

- Temperaturë, Puls, Presion i gjakut
- Por: interpretojini rezultatet e vetëmonitorimit me kujdes dhe në kontekstin e vlerësimit tuaj më të gjerë

## 6. Vendimi dhe veprimi

- Nëse është e mundur, trajtoni pacientin me barnat në shtëpi ose jepni një mjekim të ri
- Këshilloni dhe organizoni vizitë ndjekëse duke marrë parasysh mundësitë
- Ri-akutizimi (Përdorni Algoritmin e Triazhit dhe Menaxhimit në Shtëpi):
- Gjatë ri-akutizimeve të rënda dhe kërcënuese për jetën NJOFTONI Ambulancën (Shihni Shenjat e rrezikut)
- Vizitoni personalisht pacientë me disa ri-akutizime në klinikën/QSH-në tuaj
- Mbani shënim çdo gjë që diskutoni në kartelën mjekësore të pacientit
- Mos hezitoni të thërrisni pacientin tuaj në klinikë nëse dyshoni për përkeqësim të astmës për një rivlerësim më të saktë

## 7. Shenjat e rrezikut

- Pa frymë i qetë, i ulur
- I përgjumur, konfuz, ose i shqetësuar
- Nuk është i aftë të flasë me fjali të plota
- Ritmi i frymëmarrjes > 30 frymëmarrje/minutë
- Rrahjet e zemrës > 120 rrahje për minutë
- PEF ≤ 50 % nga parashikimi ose vlera personale më e mirë ose i pamundur që të kryejë PEF

# Protokolli i konsultës në distancë, menaxhimi i atakut të astmës

